



**Në bazë të nenit 12. alineja 2. pika d të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale ,  
nenit 31. alineja 1. të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm të Kosovës  
dhe nenit 32.2. të Statutit të komunës të Dragashit, në seancën e rregullt  
të mbajtur më 29.05. 2009, miraton këtë :**

## **R R E G U L L O R E**

**Për sjellje dhe disiplinë të nxënësve të shkollës së mesme të lartë të  
komunës së Dragashit**

### **I - DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

#### **Neni – 1**

**Me këtë Rregullore për sjellje dhe disiplinë të nxënësve të shkollave të mesme të (në  
tekstin e mëtejme: "Rregullore") përcaktohen rregullat e sjelljes së mirë, të  
disiplinës, të respektimit të rendit të brendshëm (shtëpiak) në shkollat e mesme të  
komunës së (në tekstin e mëtejme: "Shkolla").**

#### **Neni – 2**

**Kjo rregullore është obliguese për nxënësit e shkollës së mesme, për sa kohë që ata  
qëndrojnë në ambientet shkollore.**

#### **Neni – 3**

**Nxënës i shkollës së mesme të lartë konsiderohet çdo i ri (e re) që pas mbarimit të  
arsimit të ulët (kl. VI-IX) ka regjistruar dhe vijon ndonjërin nga programet e  
shkollimit të mesëm ,(kl. X, XI, XII apo XIII) publik apo privat.**

#### **Neni – 4**

**Sjellja dhe disiplina e nxënësve në shkollë ka karakter edukativ dhe njëherit është  
komponentë e rëndësishme e nivelit të zhvillimit të personalitetit të nxënësit, e cila  
reflektohet drejtëpërdrejt në veprimtarinë e përgjithshme shkollore.**

#### **Neni - 5**

**Me dispozitat e kësaj rregulloreje përkufizohen të drejtat, detyrat, obligimet, përgjegjësitë dhe masat edukative-disiplinore që i shqiptohen nxënësit gjatë qëndrimit në shkollë.**

#### **Neni – 6**

**Për mosrespektimin e rregullave të shkollës, të përcaktuara me ligj dhe me akte tjera normative, nxënësit i shqiptohen vërejtje dhe masa disiplinore të aplikueshme për atë kategori nxënësish.**

#### **Neni – 7**

**Në përjashtim të rasteve të rregulluara me vendime të posaçme, nxënësit mund të qëndrojnë në ambientet shkollore vetëm gjatë orarit të punës së shkollës, për sa kohë të jenë të angazhuar në procesin mësimor, në praktikën profesionale, në punën prodhuese, apo në aktivitetet e lira të nxënësve të organizuara nga shkolla.**

#### **Neni – 8**

**Është detyrë e kujdestarit të klasës dhe e personelit tjetër mësimor t'i informojë nxënësit dhe prindërit e tyre me dispozitat e kësaj rregulloreje, me rendin shtëpiak në shkollë, si dhe me kodin e mirësjelljes së nxënësve.**

#### **Neni – 9**

**Një ekzemplar i kësaj rregulloreje vendoset në tabelën e njoftimeve në lokalet shkollore, në mënyrë që të kenë mundësi ta lexojnë të gjithë të interesuarit.**

#### **Neni – 10**

**Rregullat për disiplinën dhe sjelljen e nxënësve shpallën në gjuhët e nxënësve që vijojnë në atë shkollë.**

#### **Neni – 11**

**Në pajtim me nenin 31.4 të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm të Kosovës – MASHT – 2004, ( në tekstin e mëtejme:”Ligji”) si dhe të Udhëzimit Administrativ të MASHT nr.4/2007 të datës 09.03.2007, është përgjegjësi e drejtorit të shkollës për jetësimin e Rregullorës dhe rendit shtëpiak në shkollë, si dhe për trajtim adekuat të çdo rasti që bie ndesh me aktet normative në fuqi.**

#### **Neni – 11.1**

**Përgjegjësia e paraparë me nenin 11 bartet edhe te zëvendës drejtori i shkollës.**

#### **Neni – 12**

**Kjo Rregullore hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në tabelën e shpalljeve të shkollës dhe e shfuqizon rregulloren e këtyllë të mëparshme.**

#### **Neni - 13**

**Mbështetur në nenin 31.1 të Ligjit, çdo Drejtori Komunale e Arsimit dhe Kulturës (në tekstin e mëtejme: ”DKAK”) ka për obligim miratimin e rregulloreve për**

disiplinë dhe sjellje të nxënësve, të hartuara nga secila shkollë për përdorim të brendshëm.

#### Neni – 14

Në preambulën e rregullores së shkollës duhet të figurojë edhe:

#### Neni – 14.1

Shkolla e Mesme “.....” në ..... është shkollë e mesme..... klasëshe e drejtimit ..... dhe e profilit.....

#### Neni – 14.2

Kjo shkollë amë i ka edhe.....paralele të ndara në .....(..... klasëshe), në ..... (..... klasëshe) dhe në ..... (.....klasëshe)

#### Neni – 14.3

Në këtë shkollë mësimi zhvillohet në gjuhën mësimore ....., në gjuhën mësimore ..... dhe në gjuhën mësimore .....

#### Neni – 15

Qëllimet e arsimit të mesëm janë:

- a) të zhvillojë personalitetin, talentin dhe potencialin e aftësive fizike dhe psikike të nxënësve,
- b) të kultivojë te nxënësit ndjenjen e respektimit të të drejtave dhe të lirisë themelore të njeriut,
- c) të kultivojë ndjenjen e respektit dhe të dashurisë:
  - ndaj familjes,
  - ndaj mësimdhënësve dhe personelit tjetër në shkollë,
  - ndaj personave të moshuar, nevojtarë apo me gjendje krize,
  - ndaj identitetit kulturor, gjuhësor dhe kombëtar,
  - ndaj Republikës së Kosovës dhe komuniteteve që jetojnë në të, dhe
  - ndaj qytetërimeve, diversiteteve dhe trashëgimive kulturore, të cilat ndryshojnë nga ato që u përket nxënësi i caktuar;
- ç) t’i përgatitë nxënësit për jetë të përgjegjshme në shoqëri të lirë, demokratike, në frymën e mirëkuptimit, paqes, tolerancës, barazisë gjinore, miqësisë mes popujve, mes grupeve etnike, përkatësive kombëtare e fetare, si dhe të prejardhjeve të tjera.

## II - TË DREJTAT E NXËNËSIT

#### **Neni - 16**

**Si subjekt i rëndësishëm i bashkësisë shkollore, nxënësi i gëzon të drejtat e tij të patjetërsueshme:**

#### **Neni – 16.1**

**E drejta t'i njohë dhe t'i gëzojë të drejtat e veta të përcaktuara me aktet normative të shkollës, në pajtim me Ligjin, me Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës, në pajtim me Konventën Ndërkombëtare mbi Liritë dhe të Drejtat e Njeriut dhe me konventat kombëtare dhe ndërkombëtare dhe me aktet e tjera universale .**

#### **Neni – 17**

**E drejta e arsimimit në shkollën publike apo private, të licencuar nga MASHT, (të përgjithshme, profesionale, artistike) në drejtimin, në profilin, në gjuhën mësimore dhe në vendin e preferuar nga nxënësi dhe prindërit e tij, në përputhje me kushtet e konkursit.**

#### **Neni – 18**

**T'i shfrytëzojë resurset shkollore në favor të zhvillimit me cilësi të procesit mësimor, të aktiviteteve të lira të nxënësve, çasjes eksperimentale, punës praktike-prodhuese, etj.**

#### **Neni – 19**

**E drejta e të shprehurit të lirë për problemet që e shqetësojnë, nxënësin, paralelen e tij, klasën e tij dhe shkollën e tij në çfarëdo forme: me gojë, me shkrim, me figura, publikisht dhe pa censurë, pa i cenuar të drejtat e të tjerëve.**

#### **Neni – 20**

**E drejta t'i dëgjojë dhe të jetë i dëgjuar nga të tjerët.**

#### **Neni – 21**

**E drejta të jetë i mbrojtur nga çfarëdo qëndrimi përbuzës e diskriminues, për arsye relevante apo të supozuara, lidhur me përkatësinë gjinore, racore, gjendjen sociale, deklarinimin fetar, hendikepet fizike a psikike, opinionet politike, përkatësinë etnike, sociale,pronësore, të vendlindjes apo të rrethanave të tjera të nxënësit apo të familjes së tij.**

#### **Neni – 22**

**E drejta të ketë siguri ambientale dhe shëndetësore gjatë qëndrimit në ambientet shkollore dhe në aktivitetet e organizuara jashtë objekteve shkollore.**

#### **Neni – 23**

**E drejta të shprehë mospajtim me qëndrimet a vendimet e pamatura, të ushtrojë ankesë te organet e shkollës apo në instanca më të larta të arsimit, sa herë gjykon se i është cenuar e drejta.**

#### **Neni – 24**

**E drejta në stimulim – shpërblim moral dhe material**

#### **Neni – 24.1**

**E drejta të avancohet në bazë të suksesit të përgjithshëm, në bazë të talentit të dëshmuar në lëmi të veçantë, në aktivitete të lira të nxënësve apo për sjellje shembullore, nëpërputhje me normativat në fuqi.**

#### **Neni – 24.2**

**Për nxënës të shkollave të mesme të larta praktikohen këto forma të stimulimit moral:**

- lavdërim publik para kolektivit të paraleles,
- lavdërim publik para kolektivit të klasës,
- lavdërimi para kolektivit të nxënësve të shkollës,
- afishimi i fotografisë së nxënësit në vend të dukshëm në shkollë apo jashtë saj dhe
- ndarja e mirënjohjes, fletënderit apo e ndonjë forme tjetër stimuluese, të cilat mund të emërtohen me emrin “Naim Frashëri”.

#### **Neni – 24.3**

**Stimulimi material i nxënësit përfshin akordimin e dhuratave të ndryshme, qoftë nga fondi I shkollës, DKASH-së, organeve të pushtetit lokal, nga sponsorë të ndryshëm, nga miq të shkollës, njerëz të vullnetit të mirë, OJQ, shoqata bëmirese, etj.**

#### **Neni – 24.4**

**Mënyra, forma dhe kriteret e stimulimit të nxënësit rregullohen me aktet normative të shkollës.**

#### **Neni – 24.5**

**Shkolla ka obligim të sigurojë mundësi për realizimin e këtyre të drejtave për të gjithë nxënësit e merituar, pa dallim nga asnjë formë përkatësie.**

#### **Neni – 25**

**E drejta të marrë pjesë në aktivitetet e lira të nxënësve (lëndore-shkencore, kulturoreartistike, sportive-rekreative dhe teknike-ekonomike).**

#### **Neni – 26**

**E drejta të zgjedhë dhe të jetë i zgjedhur, të marrë pjesë në mbledhje të asociacioneve shkollore, në të cilat marrin pjesë nxënësit si dhe strukturat e tjera shkollore apo jashtëshkollore.**

#### **Neni – 27**

**E drejta të aderojë në organizata, shoqata, klube, seksione dhe grupe të ndryshme me interes shoqëror: në kuadër të shkollës apo jashtë saj, gjithnjë në përputhje me Ligjin dhe rregullat e shkollës.**

**Neni – 28**

**E drejta të jetë i përfshirë në aktivitete të lira të nxënësve, që organizohen në nivel paraleleje, klase, shkolle a më gjërë.**

**Neni – 29**

**E drejta në pjesëmarrje, kur të gjykohet e arsyeshme, në veprimtari apo gara të nivelit komunal, rajonal, kombëtar apo ndërkombëtar duke përfshirë edhe arsyetimin e mungesave për sa kohë zgjatë manifestimi.**

**Neni – 30**

**E drejta t'i lëshohet dokumenti përkatës për kryerjen e klasës, shkollës, apo dokumente të tjera që janë në kompetencë të shkollës.**

**Neni – 31**

**E drejta të gëzojë privilegje të posaçme për merita të veçanta, sipas vlerësimit të ndonjë organi shkollor apo të ndonjë asociacioni tjetër mikst.**

**Neni – 32**

**E drejta t'i shprehen mirënjohje dhe të jetë i shpërblyer për arritje të veçanta, si në procesin mësimor, ashtu edhe në aktivitete të lira të nxënësve, në gara karakteresh dhe nivelesh të ndryshme.**

**Neni – 33**

**E drejta t'i shfrytëzojë me nikoqirllëk hapësirat dhe pasuritë e tjera shkollore në dispozicion.**

**Neni - 34**

**E drejta ta shfrytëzojë bibliotekën e shkollës, ta ruajë, ta lexojë dhe ta kthejë me kohë e të padëmtuar librin e huazuar, në pajtim me rregullat dhe orarin e punës së bibliotekës.**

**Neni – 35**

**E drejta t'i shfrytëzojë me kreativitet, me qëllim freskimi dhe çlodhjeje, pushimet mes orëve të mësimi.**

**Neni – 36**

**E drejta që, në rast nevoje, të kërkojë leje për largim të përkohshëm nga ora e mësimi apo të mungojë atë ditë nga mësimi.**

**Neni – 37**

**E drejta në mësimdhënie të përshtatur aftësive dhe prirjeve individuale dhe kolektive të nxënësit.**

**Neni – 38**

**E drejta në zhvillimin e talentit dhe prirjes për lëndët mësimore apo për aktivitete të lira të nxënësve.**

#### **Neni – 39**

**E drejta t'i shprehë lirisht opinionet lidhur me mbarëvajtjen e punës edukative-arsimore, kulturore, argëtuese, në shkollë, duke pasur në konsideratë:**

- **kualitetin e procesit mësimor,**
- **përmbajtjet e kurrikulës shkollore,**
- **përshtatshmërinë e teksteve lëndore shkollore,**
- **punën profesionale-pedagogjike të mësimit nxënësve,**
- **kushtet e punës gjatë qëndrimit në shkollë, dhe**
- **shqetësimet eventuale që e preokupojnë nxënësin, paralelen e tij, klasën e tij , organizatën e tij (subjektin e tij) apo shkollën në tërësi.**

#### **Neni – 40**

**E drejta të angazhohet për zgjedhjen e lirë (me konsensus grupi, paraleleje, klase, shkolle) të lëndëve të mësimit zgjedhor.**

#### **Neni – 41**

**E drejta t'i vlerësohet dhe respektohet dinjiteti dhe të jetë i mbrojtur nga çdo formë përbuzjeje, dhune, denigrimi, poshtërimi apo ndëshkimi fizik a psikik.**

#### **Neni – 42**

**E drejta t'i kërkojë dhe t'i marrë me kohë (jo më larg se 48 orë) nga mësimit nxënësi punimet e tij me shkrim (provimet, hartimet, testimet, vizatimet, etj.) më qëllim që t'i analizojë, përkryej, apo të reflektojë për to, sidomos kur nxënësi është i pakënaqur me vlerësimin (notimin) e atij punimi.**

#### **Neni – 43**

**E drejta që, në bazë të kërkesës së arsyeshme të prindit, (nëse është në dobi të nxënësit), drejtori i shkollës mund t'i japë leje nxënësit për dy javë mungesë nga shkolla, kurse kujdestari i klasës mund t'i japë leje deri tri ditë mungesë nga shkolla, pa arritur kërkesa deri te drejtori i shkollës.**

#### **Neni – 44**

**E drejta që, në rast pakënaqësie me cilësinë e mësimit nxënësve apo sjelljes jokorrekte të mësimit nxënësve, gjendjen higjieniko-sanitare nxënësi, nëpërmes prindit, ka të drejtë sensibilizimi të çështjes, apo të drejtë ankese:**

- **te kujdestari i klasës,**
- **te drejtori i shkollës dhe**
- **në DKAK, SIA (Sektori i Inspeksionit të Arsimit) apo në MASHT.**

#### **Neni – 44.1**

**I pakënaqur me gjendjen higjieniko-teknike të ambienteve mësimore, laboratorike apo prodhuese, brenda dhe jashtëshkollore, nxënësi nëpërmes prindit ka të drejtë**

ankese si në DKAK, SIA dhe MASHT obligohen të garantojnë shqyrtimin objektiv dhe me kompetencë të këtyre ankesave.

#### Neni – 45

Nxënësi, i cili nuk ka mundësi që në mënyrë të kënaqshme të përfitojë nga mësimdhënia e zakonshme, e gëzon të drejtën të përfshihet në formën më të përshtatshme të arsimimit special.

#### Neni – 45.1

Është detyrë e DKAK që sipas mundësisë financiare t'i sigurojë nxënësit këtë formë arsimimi:

- duke hapur klasa të bashkëngjitura pranë shkollave ekzistuese,
- duke hapur shkolla speciale me pëlqim dhe financim nga MASHT,
- duke siguruar këtë formë arsimimi në institucione të licencuara për këtë jashtë komunës së vet

#### Neni – 45.2

Kujdes i veçantë duhet kushtuar fëmijëve me nevoja të veçanta, në përzgjedhjen e formës më të përshtatshme të arsimimit special, (pas një vlerësimi profesional) i cili duhet të jetë i barasvlefshëm me shkollimin e zakonshëm.

### **III - OBLIGIMET (DETYRIMET) E NXËNËSIT**

Krahas të drejtave që i gëzon, nxënësi ka edhe obligimet (detyrimet), respektivisht përgjegjësitë:

#### Neni – 46

Çdo nxënës duhet t'i njohë, t'i zbatojë dhe të jetë i ndërgjegjshëm për obligimet, të drejtat dhe përgjegjësitë që ka, sipas rregullores në fuqi për rendin shtëpiak dhe regjimin e punës në shkollë.

#### Neni – 47

Të jetë në shkollë së paku 10 minuta para se të fillojë mësimi i atij turni dhe të respektojë me përpikëmeri orarin e mësimi dhe të pushimeve, të praktikës profesionale, të punës prodhuese dhe të aktiviteteve të lira të nxënësve.

#### Neni – 48

Të shkojë në shkollë i paisur me tekste shkollore dhe me mjete tjera të domosdoshme për mësim, punë praktike, aktivitete të lira të nxënësve, etj.

#### Neni – 49

Të bartë uniformën dhe ëmbelmen e shkollës gjatë orëve të mësimi, praktikës profesionale, punës prodhuese (nëse janë në zbatim), të ketë uniformën e caktuar për orët e edukatës fizike dhe sportive, si dhe papuçet, nëse praktikohen në atë shkollë.

**Neni – 50**

**Të reflektojë sjellje të kulturuar në orët e mësimit, në ambientet shkollore por edhe jashtë tyre.**

**Neni – 51**

**Të shprehë sjellje korrekte, kolegiale dhe dashamirëse ndaj nxënësve të paraleles, të klasës dhe të shkollës, pa dallim nga çfarëdo përkatësie.**

**Neni – 52**

**Të reflektojë respekt, nderim dhe frymë bashkëpunimi ndaj personelit mësikor.**

**Neni – 53**

**Të respektojë personalitetin dhe integritetin e secilit anëtar të bashkësisë shkollore.**

**Neni – 54**

**T'i ruaj, t'i kultivojë dhe t'i humanizojë ambientet shkollore dhe jashtëshkollore.**

**Neni – 55**

**Të shprehë gatishmëri për kryerjen e detyrave dhe obligimeve që i përcaktojnë organet profesionale apo menaxhuese të shkollës.**

**Neni – 56**

**Të mos e pengojë zhvillimin e procesit mësikor dhe ushtrimor të shkollës.**

**Neni – 57**

**Të reflektojë pamje të jashtme të kulturuar dhe nivel të mirë të higjienës personale.**

**Neni – 58**

**Të jetë i vëmendshëm në orën e mësimit. Ndërhyrjet e nxënësit lejohen vetëm me miratimin dhe nën mbikëqyrjen e mësimitdhënësit.**

**Neni – 59**

**Për mbajtjen e higjienës dhe rendit shtëpiak në mësonjëtoje, përgjegjës janë të gjithë nxënësit, në veçanti nxënësit kujdestarë të javës, si dhe këshilli i nxënësve i klasës.**

**Neni – 60**

**Nxënësi ka obligim për kujdesjen për ruajtjen e mobiljeve dhe inventarit shkollor, të paisjeve dhe të mjeteve të tjera të punës.**

**Neni – 61**

**Për dëmtimet e qëllimshme të mobiljeve dhe inventarit, apo të pasurisë tjetër të shkollës, pas identifikimit të fajësisë së dëshmuar, kërkohet dëmshpërblim nga prindi i nxënësit që e ka bërë dëmin dhe ndërmirren masat edukative disiplinore ndaj tij.**

**Neni – 62**

**Lartësinë e dëmshpërblimit e përcakton komisioni vlerësues i shkollës.**

**Neni – 63**

**Nxënësi obligohet të sillet në përputhje me normat e kodit etik edhe jashtë ambienteve shkollore.**

**Neni – 64**

**Për zgjidhjen e bregave dhe shqetësimeve personale apo kolektive, nxënësi duhet të kërkojë ndihmën e kujdestarit të klasës, të psikologut të shkollës, të zëvendës drejtorit të shkollës, e në raste më serioze edhe të drejtorit të shkollës.**

**Neni – 65**

**Nxënësi ka për obligim t’iu përgjigjet dhe t’i përkrahë të gjitha veprimtaritë e organizuara në shkallë paraleleje, klase,shkolle a më gjërë.**

**Neni – 66**

**Të jetë i vëmendshëm në shpenzimin e furnizimit të shkollës me: energji elektrike, ujë, shkurës, etj.**

**Neni – 67**

**T’i arsyetojë me kohë dhe më argumente mungesat nga orët e mësimin, apo nga aktivitetet e lira të nxënësve.**

**Neni – 68**

**Të kujdestarojë në ambientet shkollore sipas orarit të hartuar nga shkolla.**

**Neni – 69**

**Në rast vonese në orë të mësimin, nxënësi duhet t’i lajmërohet nxënësit kujdestar, apo mësimdhënësit kujdestar, me miratimin e tij të trokas në derë, të hyjë pa zhurmë në klasë dhe duke kërkuar falje ta njohtojë mësimdhënësin për arsyen e vonesës.**

**Neni – 70**

**Më të kryer orari i mësimin, i praktikës profesionale apo i aktiviteteve të lira të nxënësve, nxënësi obligohet ta lëshojë mësonjëtoresh, respektivisht godinën shkollore, me përjashtim të nxënësve udhëtarë, të cilët mund ta presin mjetin transportues në një kthinë të caktuar nga drejtori i shkollës për këtë qëllim.**

**Neni – 71**

**Të hyjë në mësonjëtoresh në mënyrë të kulturuar së paku 5 minuta para fillimit të mësimin.**

**Neni – 7 2**

**Kur të hyjë në klasë mësimdhënësi, drejtori apo ndonjë person tjetër i moshuar, në shenjë respekti, nxënësi duhet të ngritet në këmbë deri në shenjen e mësimdhënësit për t'u ulur, (nëse shkolla nuk e ka rregulluar ndryshe këtë çështje).**

**Neni – 73**

**T'i ruajë me kujdes gjësendet personale. Shkolla nuk garanton mosprekjen e gjësendeve të nxënësve nga persona të tjerë dhe nuk është përgjegjëse për humbjen e tyre gjatë qëndrimit të nxënësve në shkollë.**

**Neni – 74**

**Gjatë çdo pushimi në mes të orëve të mësimi, së paku njëri nga nxënësit kujdestar është i obliguar të qëndrojë në mësonjëto.**

**Neni – 74.1**

**Nxënësi kujdestar ka obligim t'ia tërheqë vërejtjen apo të raportojë te mësimdhënësi kujdestar lidhur me nxënësin që prish rendin shtëpiak në lokalet e shkollës.**

#### **IV - VEPRIME TË NDALUARA**

**Në përputhje me kodin e mirësjelljes në shkollë, për nxënësit e shkollës së mesme të lartë është e ndaluar:**

**Neni – 75**

**Shkarravitja, vizatimi, shkruarja e grafitëve, nëpër mure, mobilje apo në inventarin shkollor.**

**Neni – 76**

**Prishja e rendit ekologjik: hedhja e mbeturinave jashtë shportave (kontejnerëve), si dhe shkelja e sipërfaqeve të gjelbërta dhe dëmtimi i fidaneve në oborrin e shkollës.**

**Neni – 77**

**Pirja e duhanit në ambientet shkollore dhe në vende të tjera publike, si dhe shoqërimi me grupet e duhanxhinjve.**

**Neni – 78**

**Futja dhe konsumimi i pijeve alkoolike apo lëndëve narkotike në lokalet shkollore.**

**Neni – 79**

**Futja në shkollë, shfletimi dhe propagandimi i botimeve, revistave dhe posterëve të dyshimtë dhe joedukativë.**

**Neni – 80**

**Futja në shkollë e gjësendeve dhe mjeteve piroteknike të rrezikshme për shkaktim zjarri apo për eksplozim.**

**Neni – 81**

**Luajtja e bixhozit në shkollë dhe marrja me lojëra të fatit të çfarëdo natyre qofshin.**

**Neni – 82**

**Bartja në shkollë e armëve “të ftohta” apo të zjarrta, qofshin ato edhe “lodra”.**

**Neni – 83**

**Shoqërimi i personave të jashtëm (të panjohur) në shkollë, pa leje paraprake nga organet përgjegjëse të shkollës.**

**Neni – 84**

**Sjellja e kafshve shtëpiake apo të tjera në shkollë, nëse nuk janë kërkuar për ndonjë qëllim praktik mësimor.**

**Neni – 85**

**Nxjerrja jashtë objekteve shkollore të çfarëdo forme të pasurisë shkollore, pa leje paraprake për këtë nga organet përgjegjëse të shkollës.**

**Neni – 86**

**Të pengojë (prish) disiplinën gjatë orës së mësimi (të bëjë zhurmë, të përtypë çamçakëz etj.) si dhe pengimi dhe prishja e disiplinës edhe gjatë pushimeve në mjediset e shkollës.**

**Neni – 87**

**Shfrytëzimi i celularit, vokmenëve apo të ndonjë aparati tjetër që e tërheq vëmendjen dhe që e pengon procesin mësimor. Në të kundërtën, aparati i konfiskohet deri në ardhjen e prindit.**

**Neni – 88**

**Çdo formë e ofendimit të nxënësve të paraleles, të klasës dhe të shkollës, e mësimdhënësve, apo personelit tjetër shkollor.**

**Neni – 89**

**Çdo formë e ushtrimit të dhunës ndaj të tjerëve.**

**Neni – 90**

**Të dëmtojë bazën materiale, teknike dhe didaktike të shkollës.**

**Neni - 91**

**Të bëjë numër të palejueshëm mungesash të paarsyeshme nga procesi edukativo-arsimor.**

**Neni – 92**

**Kopjimi gjatë punës me shkrim dhe prezantimi për të vetin i punimit të tjetrit.**

**Neni – 93**

**Falsifikimi dhe keqpërdorimi i dokumentacionit shkollor.**

**Neni – 94**

**Shkaktimi i konflikteve verbale apo fizike (fyerje, rrahje) në ambientet shkollore apo rreth tyre.**

**Neni – 95**

**Përdorimi i shprehjeve banale, të pahijshme, joedukative.**

**Neni – 96**

**Të sillet pa arsye dhe me arrogancë korridoreve dhe ambienteve të tjera shkollore.**

**Neni – 97**

**Ardhja në shkollë pa tekste shkollore, pa mjete mësimi, pa uniformë sportive, me veshje dhe dukje të jashtme çoroditëse.**

**Neni – 98**

**Hyrja me vonesë të pajustificueshme në orën e mësimi, të praktikës profesionale apo të punës prodhuese.**

**Neni - 99**

**Ta lëshojë orën e mësimi, të praktikës profesionale apo të punës prodhuese pa lejen e mësimdhënësit, respektivisht të punëdhënësit.**

**Neni - 100**

**Të propagojë apo të zhvillojë në shkollë aktivitete politike, partiake, fetare etj.**

**Neni – 101**

**Të cenojë liritë dhe të drejtat e tjerëve.**

**Neni – 102**

**Nuk lejohet kopjimi i punimeve me shkrim (hartimet, testimet, punimet me shkrim, etj).**

**Neni – 103**

**Rreptësisht ndalohet çdo formë e ndëshkimit trupor apo poshtërujes të nxënësit, si dhe çdo formë e përgjimit, shpifjes dhe dezinformimit nga ana e nxënësit.**

## **V – LAVDËRIMET , MIRËNJOHJET DHE SHPËRBLIMET**

**Neni – 104**

**Në shenjë inkurajimi për arritje të veçanta, nxënësit të dëshmuar të shkollës së mesme të lartë mund t'i akordohen: lavdërime, mirënjohje dhe shpërblime:**

- për kryerje me ndërgjegje dhe me përgjegjësi të detyrave të përqafuara nga nxënësi,
- për sukses të dëshmuar dhe sjellje shembullore,
- për sjellje korrekte e me vetëdije ndaj pasurisë së shkollës,
- për sukses dhe arritshmëri të lartë në aktivitete shkollore apo jashtëshkollore,
- për bashkëpunim të ndërsjellë, aktiv dhe të suksesshëm me nxënësit e tjerë dhe me kuadrin arsimor në kuadër të procesit edukativo-arsimor,
- për sjellje të kulturuar , tolerancë, solidaritet dhe respekt të ndërsjellë ndaj pjesë marrësve në procesin edukativo-arsimor,
- për përpjekje dhe arritshmëri të veçantë në mësim, në përputhje me aftësitë dhe mundësitë e nxënësit,

- për arritje natyrash të tjera, nga lëmi i aktiviteteve shkollore, të shkruara apo të pashkruara.

#### Neni – 105

Lavdërimet, mirënjohjet apo shpërblimet për nxënës i ndajnë dhe i dorëzojnë organet e shkollës në një mënyrë dhe në një rast sa më solemn.

#### Neni – 106

Lavdërimet mund të jenë në formë:

- fletëfalënderimi, mirënjohje, plaketë, diplomë, etj,
- lavdërim me gojë, i cili mund t'i shprehet nxënësit në ndonjë rast solemn, të organizuar me rastin e ndonjë ngjarjeje domëthënëse,
- mirënjohje në formë medaljesh, shenjash, dinstiktivësh, simbolesh, etj.

#### Neni – 107

Shpërblimet për nxënës të merituar mund të jenë në formë:

- libri – beletristikë: ilustracione, material i vlefshëm grafik, komplete stilolapsash a material tjetër shkollor,
- gjëra artistike: piktura, skulptura, albume, fragmente kaliografike, etj.,
- rekuizita apo veshje sportive, respektivisht fragmente të tyre dhe
- në formë biletash për kino, teatër, cirk, manifestime sportive, pritje soleme, ekskursione, etj.

#### Neni – 108

Lavdërimet, mirënjohjet dhe shpërblimet mund t'i jepen :

- nxënësit (personalisht),
- grupit të nxënësve,
- nxënësve të një paraleleje ose të një klase dhe
- ndonjë asociacioni nxënësish

#### Neni – 109

Nxënësit kandidatë për lavdërimet dhe shpërblime propozohen:

- nga vetë nxënësit,
- nga kuadri mësimor i shkollës,
- nga organet qeverisëse dhe profesionale të shkollës dhe
- nga personat e tjerë jashtë shkollës.

#### Neni – 109.1

Lavdërimet dhe shpërblimet, në raste të përshtatshme mund t'i dorëzojë:

- përfaqësuesi i organeve qeverisëse të shkollës,
- përfaqësuesi i organeve profesionale të shkollës dhe
- ndonjë personalitet tjetër i autorizuar për këtë.

#### Neni – 110

Lavdërimi në formë të shkruar dorëzohet në formular adekuat, të cilin e miraton Këshilli i arsimtarëve, ndërkaq e dorëzon organi që e ka miratuar atë, apo drejtori i shkollës.

## **VI - AVANSIMI I NXËNËSIT**

### **Neni – 111**

Në mbështetje të Udhëzimit Administrativ të MASHT nr.25/2003, të datës 19 nëntor 2003, është përcaktuar mundësia dhe kushtet për avansimin e mundshëm të nxënësve të shkollës së mesme të lartë.

### **Neni – 112**

Avansimi i nxënësve mund të bëhet për sukses të përgjithshëm të dëshmuar gjatë viteve (klasëve) paraprake të shkollimit, si dhe për talent poashtu të dëshmuar nga një lëndë mësimore, ose nga një fushë tjetër shkencore-lëndore, kulturore-artistike, sportiverekreative, teknike-ekonomike apo të llojit tjetër.

### **Neni – 112.1**

Aktit të avansimit të një nxënësi i paraprin propozimi i argumentuar mirë për aftësitë dhe arritjet e nxënësit, të cilin mund ta bëjnë:

- këshilli i klasës (të atij nxënësi),
- kujdestari i klasës dhe
- ndonjë arsimtar që jep mësim në atë klasë (shkollë)

### **Neni – 112.2**

Propozimin e bërë, me gjithë dëshmitë plotësuese e shqyrton Këshilli i arsimtarëve, ndërkaq, raportin me shkrim për arsyeshmërinë e propozimit për avansim e përpilon drejtori i shkollës.

### **Neni – 112.3**

Procedura për avansimin e nxënësit inicohet dhe zhvillohet në gjysmëvjetorin e dytë të asaj klase, nga e cila do të avancohet nxënësi në një klasë më të lartë.

### **Neni – 112.4**

Avansimi i nxënësit mund të bëhet për jo më shumë se një klasë.

### **Neni – 113**

Avansimi i nxënësit për sukses të përgjithshëm në mësim, apo për talent të dëshmuar në ndonjë fushë të caktuar, mund të bëhet vetëm një herë gjatë shkollimit parauniversitar.

#### Neni – 114

Para se të bëhet testimi i njohurive , respektivisht i aftësive të veçanta të nxënësit, ai duhet t'i nënshtrohet testimit të nivelit të intelegjencës, gjë që bëhet nga një komision profesional I autorizuar prej Sektorit të Inspeksionit të Arsimit ku graviton ajo shkollë.

#### Neni – 115

Për avansimin e nxënësit përgatitet ky dokumentacion valid:

- propozimi me shkrim i bërë nga propozuesi,
- raporti me shkrim nga Këshilli i arsimtarëve, i cili më parë e ka shqyrtuar propozimin,
- të dhënat vlerësuese nga testimi i njohurive – aftësive të nxënësit,
- të dhënat për vlerësimin e intelegjencës së nxënësit,
- dëshmia për suksesin e arritur gjatë klasave (viteve) të mëparshme dhe
- të dhënat për talentin e dëshmuar në ndonjë fushë të caktuar veprimi

#### Neni – 116

Vendimin definitiv për avansimin e nxënësit, sipas kritereve të përcaktuara më lart e merr MASHT.

## **VII - MASAT EDUKATIVE - DISIPLINORE**

#### Neni – 117

Nxënësi është i obliguar t'i respektojë rregullat e sjelljes dhe të punës arsimoredukatve dhe rendin shtëpiak në shkollë, në të kundërtën do t'i shqiptohen masat edukative-disiplinore në fuqi, në tekstin e mëtejme “Masat”.

#### Neni - 118

Shqiptimi i masave ka për qëllim:

- t'i korrektojë sjelljet e palejueshme që i bëjnë dëm personalitetit të nxënësit;
- të krijojë klimë të volitshme mësimi e pune në shkollë dhe jashtë saj;
- të vërë në mbrojtje ambientet dhe pasuritë shkollore;
- të përfilltet dhe zbatohet ligjshmëria dhe nënligjshmëria në shkollë; dhe
- të respektohen normat e garantuara me Konventa Ndërkombëtare.

#### Neni - 119

Masat i shqiptohen nxënësit për:

- numër të palejuar të mungesave të paarsyetuara;
- vonesa të paarsyeshme në orët mësimore;
- largim të parakohshëm pa leje nga orët mësimore;

- ardhje në shkollë pa fletore, tekste shkollore, uniformën sportive për orët e edukatës fizike dhe sportive dhe pa pajisje të tjera të domosdoshme për mësim dhe aktivitete të lira të nxënësve, përveç rasteve të justifikuara si raste sociale apo mungesë të kujdesit prindëror;
- mosangazhim të duhur në orët mësimore;
- moskryerjen e detyrave të shtëpisë apo të punimeve të tjera me të cilat e kanë angazhuar mësimdhënësit;
- sjellje të pahijshme në shkollë dhe jashta saj;
- prishjen e rendit shtëpiak dhe qetësisë në paralele-klasë dhe në shkollë, (lëvizje të pakontrolluara, bërtitje të tepruara, etj.);
- diskutime të pavend, konsumim të ushqimit gjatë orëve mësimore dhe të aktiviteteve të lira të nxënësve, dukje dhe qëndrim të pahijshëm, moskujdesje për higjienën personale, të mësonjëtores apo të ambienteve të tjera shkollore;
- kopjim të punimeve me shkrim: hartime, testime, vizatime etj.;
- shkelje të lehta dhe të rënda të rregullave dhe të rendit shtëpiak në shkollë;
- çrregullim të raporteve në mes të nxënësve gjatë procesit mësimor dhe gjatë qëndrimit në shkollë;
- përsëritjen e thyerjeve të rregullave dhe të rendit shtëpiak të shkollës;
- dëmtim të pasurisë shkollore apo tjetër publike; dhe
- nëse pengon përpjekjet për menjanimin e dukurive negative në shkollë.

#### Neni - 120

Nxënësit që nuk iu përmbahet rregullave dhe rendit shtëpiak të shkollës, apo që bie ndesh me normat ligjore dhe nënligjore i shqiptohen këto masa:

- “Vrejtje me gojë”;
- “Vërejtje me shkrim”;
- “Largim i përkohshëm nga aktivitetet e lira të nxënësve”;
- “Transferim në një paralele tjetër të së njëjtës klasë”;
- “Ulje e notes së sjelljes”;
- “Largim i përkohshëm nga shkolla deri në 3 ditë mësimi”;
- “Largim i përkohshëm nga shkolla deri në një muaj”;
- “Largim i përkohshëm nga shkolla më tepër se një muaj”;
- “Transferim në një shkollë tjetër (të njëjtën) më të afërme” dhe
- “Përgjashtim nga shkolla për një vit shkollor”.

#### Neni - 121

Masa “Vërejtje me gojë” i shqiptohet nxënësit për shkelje të lehta të rregullave dhe rendit shtëpiak të shkollës, si për:

- mungesa të shpeshta në mësim dhe nga aktivitete të lira të nxënësve;
- mungesa të paarsyetuara;
- pengim të mësimin apo formave të tjera arsimore-edukative;
- sjellje dhe veprime që e dëmtojnë imazhin e shkollës;
- mospërmbushje të përgjegjësisë të obligimeve shkollore; dhe

- shkeljen e rregullave të shkollës në atë masë që nuk parashihen masa tjera më të rrepta.

#### Neni - 122

Masa “Vërejtje me shkrim” i shqiptohen nxënësit për shkelje më të rënda të rregullave dhe rendit shtëpiak të shkollës, sidomos kur i përsëritë ato, si për:

- ikje apo mungesë kolektive nga mësimi apo nga aktivitetet e tjera arsimore edukative;
- sjellje jo të mirë ndaj nxënësve të tjerë (shprehje vulgare, kërcnime, nxitje apo pjesëmarrje në rrahje);
- disa vërejtje të shënuara në ditar të klasës nga mësimdhënësit;
- sjellje të papërgjegjshme ndaj pasurisë shkollore;
- mosdorëzim apo fshehje të fletëtestit apo fletëprovimit;
- numër të madh mungesash të paarsyetuara nga orët mësimore;
- përvetësim (grabitje) të pasurisë së shkollës, të nxënësve, të të punësuarve apo të personave të tjerë në shkollë;
- sjelljen apo përdorimin e mjeteve piroteknike në ambientet shkollore, gjatë vizitave, pikniqeve dhe shëtitjeve etj.;
- organizim të shëtitjeve grupore, të koncerteve a të aktiviteteve të tjera, në emër të shkollës, për ç’gjë nuk është siguruar pelqimi (leja) paraprak i organeve kompetente të shkollës dhe
- shkeljen e rregullave dhe rendit shtëpiak të shkollës në atë masë sa që nuk I shqiptohen masat “Vërejtje me gojë”.

#### Neni - 123

Masa “Largim i përkohshëm nga aktivitete të lira të nxënësve, vizita, pikniqet, shëtitjet dhe ekskurzionet” i shqiptohen nxënësit:

- nëse reflekton disa herë sjellje jo të mira, të përkufizuar në nenin 122;
- për ofendim apo kundërshtim të vrazhdë (verbal) ndaj kujdestarit të klasës ose ndaj mësimdhënësve apo personelit tjerër të shkollës, gjatë apo pas orëve mësimore, brenda apo jashtë shkollës;
- për dëmtim të qëllimshëm të bazës materiale, teknike dhe didaktike të shkollës;
- për moszbatim të rregullave të shkollës edhe pasi t’i jenë shqiptuar masat nga nenet 121 dhe 122 dhe
- nëse me sjelljet e tij bëhet pengesë për zhvillimin normal të procesit mësimor apo të aktiviteteve të lira të nxënësve.

#### Neni - 124

Masa “Transferim në një paralele tjetër të së njëjtës klasë” (në kuadër të shkollës sonë) shqiptohet nxënësit nëse përsëritet sjellja e nxënësit të përkufizuar me nenin 123 dhe nëse organi që e shqipton masën është i bindur se ndërrimi i shoqërisë dhe i ambientit mësimor do të jetë i dobishëm për vetë nxënësin, por edhe për nxënësit e paraleles nga e cila transferohet.

#### Neni - 125

Masa “Ulje të notës së sjelljes” i shqiptohet nxënësit për sjellje tjera jokorekte në shkollë apo jashtë saj dhe për moszbatim të rregullave të shkollës edhe pasi t’i jenë shqiptuar masat nga nenet 121, 122, 123, dhe 124, si dhe për numër të palejuar të mungesave të paarsyetuara:

- për 8 deri 24 mungesa të paarsyetuara, nxënësit i ulet nota e sjelljes na “Shembullore” në “E mirë”;
- për 25 deri 35 mungesa të paarsyetuara, nxënësit i ulet nota e sjelljes nga “E mirë” në “Jo e mirë”; dhe
- për më tepër se 35 mungesa të paarsyetuara nxënësi përjashtohet nga shkolla për një vit shkollor.

#### Neni - 126

Masa “Largim i përkohshëm nga shkolla deri në 3 ditë mësimi” i shqiptohet nxënësit për:

- rrahje me nxënësit e paraleles-klasës apo të shkollës, me pasoja shqetësuese;
- sjellje vagabondazhi dhe amoraliteti në mësonjëtoare apo jashtë saj;
- ngacmin seksual ndaj nxënësve të paraleles-klasës apo të shkollës, Brenda apo jashtë shkollës;
- sjellje agresive, tentim sulmi fizik, respektivisht ofendime të rënda ndaj kujdestarit të klasës apo mësimdhënësve a personelit tjetër të shkollës, brenda dhe jashtë shkollës.
- refuzim urdhërash të drejtorit të shkollës;
- dëmtime të rënda dhe të qëllimshme të bazës materiale, teknike dhe didaktike të shkollës;
- pirjen e duhanit në ambientet shkollore apo rreth tyre;
- konsumin apo shpërndarje të të gjitha llojeve të lëndëve narkotike,
- mbajtje në shkollë të armeve të ftohta apo të zjarrta dhe
- raste të tjera të rënda të shkeljes së rregullave dhe rendit shtëpiak në shkollë.

#### Neni - 127

Masat “Largim i përkohshëm nga shkolla deri në një muaj” dhe “Largim i përkohshëm nga shkolla më tepër se një muaj” i shqiptohen nxënësit në mënyrë graduale nëse i përsërit sjelljet e përkufizuara me nenin 126.

#### Neni – 128

Masa “Transferim në një shkollë tjetër të njëjtë të afërme” i shqiptohet nxënësit kur vlerësohet se qëndrimi i mëtejme i atij nxënësi në paralele dhe në shkollë është I dëmshëm për nxënësit e tjerë dhe për personelin edukativ-mësimor të shkollës.

#### Neni – 129

Masa “Përjashtim nga shkolla për një vit shkollor” i shqiptohet nxënësit për shkeljet e rregullave dhe rendit shtëpiak të shkollës në mënyrë më të rëndë, siç janë:

- nëse i bën më tepër se 35 mungesa të paarsyetuara gjatë vitit shkollor, me kusht që të jetë i paralajmëruar kur i bën 30 mungesa;
- për ofendime të rënda ndaj mësimdhënësve dhe punëtorëve të tjerë të shkollës;
- për pengim të qëllimshëm të kryerjes së detyrave të punës në shkollë dhe jashtë saj;
- për bërjen e pengesave ndaj nxënësve të cilët i vijnë mësimet ose marrin pjesë në aktivitete të tjera;
- për falsifikim dhe parashtrim të rrjeshëm të dokumentacionit shkollor (libri i klasës, libri amë, dëftesa, çertifikata, diploma, etj.);
- për nxitje dhe pjesëmarrje në rrahje individuale dhe kolektive;
- për paraqitje të rrjeshme në provim në vend të personit tjetër dhe
- për sjelljen në shkollë të armeve të ftohta dhe të zjarrta, mjeteve piroteknike dhe mjeteve të tjera të rrezikshme për jetë.

#### Neni – 130

Nxënësit të cilit i shqiptohet masa në bazë të nenit 129 nuk lirohet nga përgjegjësia materiale nëse ngarkohet me të.

#### Neni – 131

Nxënësi, të cilit i shqiptohet masa në bazë të nenit 129, ose i ka bërë më tepër se 35 mungesa të paarsyetuara, humb statusin e nxënësit të rregullt në atë shkollë, por nuk i mohohet e drejta për regjistrimin në ndonjë shkollë tjetër gjatë vitit të njëjtë shkollor.

#### Neni - 132

Masat nga neni 120 i propozojnë:

- këshilli i nxënësve të klasës;
- mësimdhënësi klasor ose kujdestari i klasës;
- cilido mësimdhënësi i shkollës;
- organet profesionale dhe qeverisëse të shkollës dhe
- këshilli i prindërve.

#### Neni - 133

Propozimi për shqiptimin e masës (përveç “Vërejtjes me gojë”) përgatitet me shkrim dhe në të duhet të ceket forma dhe pesha e gabimit, vendi dhe koha e bërjes së gabimit dhe çfarë efekti apo kundërefekti prodhon, si dhe i njëjti përgatitet në afatë prej 7 ditësh nga dita e bërjes së gabimit.

#### Neni - 134

Para se t’i shqiptohet cilado masë, nxënësit duhet ofruar mundësia që ta parashtrorë gojarisht rastin, fajsinë e tij, para personit zyrtar të autorizuar për trajtimin e çështjes, si dhe duhet mundësuar që edhe prindit të tij që të deklarohet për çështjet lidhur me fëmijën e tij.

#### Neni - 135

Masat ndaj nxënësit shqiptohen në mënyrë graduale, përveç në rastet e shkeljeve të rënda të rregullave dhe rendit shtëpiak të shkollës, apo të rrezikshmërisë së mundshme, kur nxënësit detyrimisht dhe automatikisht mund t'i shqiptohet edhe masa më e rëndë.

#### Neni – 136

Masën “Vërejtje me gojë” e shqipton kujdestari i klasës .

#### Neni - 137

Masat “Vërejtje me shkrim”, “Largim i përkohshëm nga aktivitetet e lira të nxënësve”, “Transferim në një paralele tjetër të së njëjtës klasë”, “Ulje e notes së sjelljes” dhe “Largim i përkohshëm nga shkolla deri në tri ditë mësimi” i shqipton drejtori i shkollës.

#### Neni - 138

Masën “Largim i përkohshëm nga shkolla deri në një muaj” e shqipton drejtori i shkollës me pëlqimin e DKAK-së.

#### Neni - 139

Masat “Largim i përkohshëm nga shkolla më tepër se një muaj”, “Transferim në një shkollë tjetër (të njëjtën) më të afërme” dhe “Përjashtim nga shkolla për një vit shkollor” me kërkesën dhe arsyetimin valid të drejtorit të shkollës i shqipton Komuna, respektivisht DKA.

#### Neni - 140

Për masën e shqiptuar ndaj ndonjë nxënësi nga neni 127 duhet njoftuar me shkrim:

- vetë nxënësin;
- prindin e nxënësit;
- paralelen apo Këshillin e nxënësve të paraleles-klasës;
- organet qeverisëse dhe profesionale të shkollës dhe
- vetëm për masën e shqiptuar “Përjashtim nga shkolla për një vit shkollor” lajmërohen të gjithë nxënësit e shkollës nëpërmes librit të lajmërimeve.

#### Neni - 141

Kundër masës së shqiptuar nga neni 121 nxënësi dhe prindi i tij kanë të drejtë ankese me shkrim drejtorit të shkollës, në afatë prej 8 ditësh nga dita e komunikimit të kësaj mase.

#### Neni - 142

Kundër masës së shqiptuar nga neni 122, 123, 124, 125 dhe 126 nxënësi dhe prindi i tij kanë të drejtë ankese me shkrim Këshillit të shkollës, në afatë prej 8 ditësh nga dita e komunikimit të kësaj mase.

#### Neni - 143

**Kundër masës së shqiptuar nga neni 127, 128 dhe 129 nxënësi dhe prindi i tij kanë të drejtë ankese me shkrim Sektorit të Inspektimit të Arsimit (SIA), në afatë prej 8 ditësh nga dita e komunikimit të kësaj mase.**

#### **Neni - 144**

**Ankesa e bërë me kohë e shtyn përmbarimin e masës së shqiptuar, deri në shqyrtimin definitiv të ankesës së parashtruar. Vendimi i organit shqyrtues të ankesës është përfundimtar.**

#### **Neni - 145**

**Organi që e shqyrton ankesën e parashtruar ka mundësi:**

- të vërtetojë masën e shqiptuar;
- të hedhë posht masën e shqiptuar; dhe
- ta zëvendësojë masën e shqiptuar me ndonjë masë tjetër (më të lehtë apo më të rëndë).

#### **Neni - 146**

**Masat nga nenet 126 dhe 127 nuk ndikojnë në shtimin e numrit të mungesave të paarsyetuara, por as nuk i shlyejnë ato, pra do të evidentohen dhe do të jenë të arsyeshme.**

#### **Neni - 147**

**Çdo masë shqiptohet pas një pune të gjerë edukative, duke përfshirë informimin me kohë të nxënësit për të drejtat, obligimet, përgjegjësitë dhe sanksionet që mund t'i bartë.**

#### **Neni - 148**

**Masa e shqiptuar do të ketë kuptim dhe efekt nëse përcaktohet me maturi dhe me kohë, duke pasur parasysh efektim dhe kundërefektin, moshën, psikologjinë dhe personalitetin e nxënësit, respektivisht subjekti i cili e shqipton masën duhet ta ketë parasysh individualitetin dhe veçoritë e nxënësit, karakterin dhe gjendjen emocionale dhe familjare, statusin shoqëror, rrethin ku jeton e vepron dhe rrethana të tjera.**

#### **Neni - 149**

**Masat shqiptohen vetëm për gabimet e bëra gjatë atij viti shkollor dhe për të njëjtin gabim të bërë shqiptohet vetëm një masë.**

#### **Neni - 150**

**Shqiptimi i masës nuk guxon të jetë i motivuar e as rrjedhojë e:**

- hakmarrjes;
- frikësimit;
- nënçmimit; dhe

- lëndimit të personalitetit-dinjitetit të nxënësit.

**Neni - 151**

Masa nuk mund t'i shqiptohet gjithë paraleles-klasës, respektivisht ajo shqiptohet vetëm nxënësit të caktuar.

**Neni - 152**

Organet që propozojnë apo shqiptojnë masa, e kanë për obligim ta përcjellin efektin e asaj mase te nxënësi dhe nëse konstatojnë se masa ka pasur efektin përmirësues dhe ka arritur qëllimin, për çka është shqiptuar, mund të propozojnë zbutjen apo shfuqizimin e asaj mase. Zbutjen apo shfuqizimin e masës së shqiptuar e bën organi i cili e ka shqiptuar masën e caktuar.

**Neni - 153**

Kur i bëhet me dije se nxënësi apo nxënësit e shkollës bartin armë të ftohta apo të zjarrta, se konsumojnë apo shpërndajnë lëndë narkotike, apo gjësende të tjera të rrezikshme, drejtori i shkollës është i obliguar ta njoftojë prindin e nxënësit (nxënësve) dhe ta informojë Shërbimin policor për këtë.

**Neni - 154**

Secila masë që i shqiptohet nxënësit bëhet pjesë e dokumentacionit pedagogjik të shkollës.

## **VIII. DISPOZITAT KALIMTARE**

**Neni – 155**

Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Rregulloreje është në kundërshtim me ndonjë Udhëzim administrativ ,apo me ndonjë akt tjetër ligjor a nënligjor më të ri, do të shfuqizohet ajo pjesë e Rregullores, për t'u fuqizuar rregullativa e re.

**Neni – 156**

Gjatë zbatimit në praktikë do të evidentohen rastet kur dhe ku duhet ndryshuar, riformuluar apo plotësuar Rregullorja.

**Neni – 157**

Edhe ndryshimet eventuale të realitetit arsimor nëpër shkollat tona mund të jenë bazë e mire për ndryshime në Rregullore.

**Neni – 158**

Rastet karakteristike të praktikës sonë shkollore, të cilat nuk janë të normuara me këtë Rregullore, apo i mungojnë fare, mund të zgjidhen me analogji nga praktika e mire pedagogjike, si dhe nga rregullativat e tjera ligjore a nënligjore.

## **IX - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

### **Neni – 159**

**Kjo rregullore synon shkallë më të lartë demokratizimi brenda sistemit tonë arsimor.**

### **Neni – 160**

**Rregullorja synon atmosferë pozitive në frymën e reformave arsimore me qëllim që, në shkollat tona, nxënësi të jetë subjekt qëndror, si në mësim edhe në aktivitete jashtëmësimore.**

### **Neni – 161**

**Çdo ndryshim apo plotësim i Rregullores bëhet në përputhje me procedurën e ndjekur për hartimin fillestar (aprovimin) të saj.**

### **Neni – 162**

**Asnjë nen, paragraf a nënparagraf i Rregullores nuk guxon të jetë në kundërshtim me dispozitat ligjore. Dispozitat e tilla të Rregullores nuk do të jenë të aplikueshme – ato do të abrogohen.**

### **Neni – 163**

**Mangësitë e kësaj Rregulloreje mund të plotësohen me amandamentimin e saj.**

### **Neni – 164**

**Kjo Rregullore hyn në fuqi 8 (tetë) ditë pas ditës së miratimit nga Kuvendi Komunal i Dragashit.**

**01 Nr.06-81/2**

**Dt.29.05.2009**

**D r a g a s h**

**KRYESUESI I KUVENDIT KOMUNAL**

---

**Lulzim Rifaj**